



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës,
trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/320
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr.K4/I45-2 Prot.

Tiranë 17/12/2025

Nr. Dok. 202502874/

Lënda: Rekomandim në lidhje me monitorimin e Shëndetit Mendor me shtretër, Shkodër.

Drejtuar: Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

TIRANË

Drejtorisë së Përgjithshme të Operatorit të Shërbimeve të
Kujdesit Shëndetësor

TIRANË

Shërbimit të Shëndetit Mendor me Shtretër në Shkodër

SHKODËR

Të nderuar,

Avokati i Popullit, vlerëson bashkëpunimin e deritanishëm dhe angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona. Në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet mbi inspektimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në institucionin tuaj në datë 09.06.2025.

Inspektimi u krye nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenit 31 të ligjit nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", i ndryshuar, sipas Planit të Inspektimit për vitin 2025 të miratuar nga Avokati i Popullit, me qëllim vlerësimin e

përgjithshëm të gjendjes së zbatimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në këtë institucion, por edhe progresit të bërë që nga vizita e fundit e MKPT-së në vitin 2024.

Në përbërje të grupit monitorues ishin znj. Nertila Qafzezi, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe z. Vullnet Topalli me detyrë ndihmës komisionerë të institucionit të Avokatit të Popullit kjo vizitë ishte e paparalajmëruar.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Institucioni i Avokatit të Popullit ka detyrimin ligjor t'ju parashtrojë gjetjet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime paraprake

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e MKPT-së në Shërbimin e Shëndetit Mendor me shtretër Shkodër për vitin 2025. Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi monitorues fillimisht u takua me Shefen e shërbimit të këtij institucioni për ta informuar mbi qëllimin e monitorimit dhe për të mbledhur informacionet e nevojshme për kryerjen e monitorimit.

Më tej, grupi i inspektimit vizitoi ambientet e këtij shërbimi. Nga inspektimi në vend, kontakti me stafin dhe pacientët, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, grupi inspektues grumbulloi informacion në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e pacientëve, respektimin e të drejtave të tyre, si dhe me problematikat e ndeshura gjatë punës.

Ligji për shëndetin mendor, në nenin 31 të tij, përcakton procedurat e monitorimit të jashtëm të shërbimit të shëndetit mendor nga Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar, që vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij. Ligji garanton vëzhgimin e rregullt me anë të inspektimeve periodike, për të respektuar të drejtat dhe standardet që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, si dhe paraqet rekomandime në organet përkatëse, **me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të pacientëve dhe sigurimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut në institucionet e kujdesit të shëndetit mendor.**

Nga informacioni, rezultoi se nuk kishin gjetur zbatim një pjesë e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm¹:

- **Nuk** ishin marrë masa, për vënien në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” të ndryshuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore dhe për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor, të burgosurve që shfaqin

¹ Rekomandim Nr. K4/I51-3 Prot, datë 24.12.2024, “Për përmirësimin e kushteve për trajtimin e pacientëve në Shërbimin e Shëndetit Mendor me shtretër”, Shkodër.

çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar.

- **Nuk** ishin marrë masa për sigurimin e një dhome izolimi në Shërbimin e Shëndetit Mendor me shtretër Shkodër në përputhje me nenin 27 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” të ndryshuar.
- **Nuk** ishin marrë masat për plotësimin e mungesave në medikamente si dhe marrjen e furnizimit të plotë me medikamente të parashikuar sipas nevojave për vitin 2025.
- **Nuk** ishin marrë masa për riparimin e të gjitha objekteve të dëmtuara në ambientet e Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër.
- **Nuk** ishin marrë masat për eliminimin e lagështirës të theksuar në të gjitha ambientet e Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër.
- **Nuk** ishin marrë masat për blerjen për shtretër dhe dyshekë të rinj për të gjitha dhomat në Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër.

Ndërkohë kishin gjetur zbatim rekomandimet si më poshtë:

1. Institucioni i Avokatit të Popullit është informuar rregullisht lidhur me planin e zhvendosjes së Shërbimit të Shëndetit Mendor me shtretër Shkodër brenda ambienteve të Spitalit Rajonal Shkodër.
2. Ishin marrë Marrjen e masave për vënien në punë të aparatit EKG, si dhe pajisjen me aparat për matjen e glicemisë.

Drejtuesja e Shërbimit me shtretër në Shkodër na informoi se të gjitha problematikat janë adresuar institucioneve përgjegjëse me një komunikim të vazhdueshëm, por ende nuk kanë marrë një zgjidhje.

Lidhur me planin e zhvendosjes së Shërbimit të Shëndetit Mendor me shtretër Shkodër brenda ambienteve të Spitalit Rajonal Shkodër , Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor NJVKSH, Shkodër, ka sqaruar² se: Kërkohe një vlerësim i një ambienti ku mund të s’postohet Shërbimi i Shëndetit mendor me shtretër, në spitalin rajonal Shkodër pasi godina aktuale do të tjetërsohet në një shërbim tjetër, kjo zhvendosje është kundërshtuar si nga Shërbimi i Shëndetit Mendor Shkodër po ashtu edhe nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër.

² Shkresa nr.969 prot, date 15.07.2024 “Në lidhje me hapjen e pavionit psikiatrik pranë Spitalit Rajonal Shkodër”

Një vendim ky i cili është kundërshtuar nga stafi drejtues dhe spitalor i spitalit psikiatrik pasi kjo zhvendosje do të sillte një situatë problematike si vijon:

- Pamundësi shtrimi me kapacitete të reduktuara;
- Pamundësi të ndarjeve sipas kategorive;
- Menaxhimi i rasteve agresive/të dhunshme në ambiente të përbashkëta me sëmundjet e tjera;
- Ambiente të kufizuara lëvizjeje;
- Mungesë ambientesh për stafin multidisciplinar;
- Mungesë të ambienteve të psikoterapisë etj.

Sa më sipër përgjatë vizitës inspektuese dhe bisedës me shefen e shërbimit u informuam se ende nuk kishte një vendimmarrje lidhur me zhvendosjen në ambientet e Spitalit rajonal Shkodër.

Duke qenë se organizimi i punës dhe i ambienteve përcaktohet nga Ligji i Shëndetit mendor nr. 44/2012, Avokati i Popullit thekson se duhet një analizë e qenësishme nga të gjithë faktorët vendimmarrës lidhur me zhvendosjen e spitalit Psikiatrik Shkodër në ambientet e Spitalit Rajonal Shkodër kjo në interesin më të lartë të pacientëve me probleme të shëndetit mendor.

Struktura dhe organika e institucionit ishte e përbërë nga 61 punonjës, prej të cilëve: 1 Shef shërbimi, 1 kryeinfermiere, 3 mjekë psikiatër, 3 psikologë, 1 punonjës social, 16 infermiere, 15 kujdestare, 10 sanitare, 4 kuzhinierë, 1 pjatolarëse, 1 farmacistë, 1 jurist, 1 punonjëse lavanderie, 2 mirëmbajtëse dhe 1 magazinier.

Spitali me shtretër Shkodër përbëhej nga 2 pavijone me kapacitet zyrtar prej 35 pacientësh. Më konkretisht, Pavijoni i Pranim-Urgjencës, Pavijoni Akut dhe Sub-Akut (Burra-Gra).

Në momentin e inspektimit, në spital ndodheshin 35 pacientë të shtruar, nga të cilët 15 bura dhe 13 gra, nga të cilët 7 pacientë sub-akutë të shtruar në urgjencë.

Sistemi i ankimit ishte në funksion edhe në rastin e kërkesave/ankesave nga grupe interesi si p.sh., shoqata apo grupime të tjera vullnetare të pacientëve, familjarë ose persona të interesuar për mbrojtjen e interesave të personave me çrregullime të shëndetit mendor. Pasi njiheshin me kërkesë/ankesën personi i ngarkuar i spitalit mblidhte të gjithë informacionin e nevojshëm (kartela, shtrime, observacione), dhe më pas gjykonte nga ana mjekësore duke u konsultuar me stafin mjekësor kthente përgjigjen që në shumicën e rasteve nënkuptonte zgjidhjen e këtij pretendimi. Drejtuesit e institucionit na informuan se ata i ndiqnin dhe më tej rastet e kërkesë/ankesave pas kthimit të përgjigjes në rrugë zyrtare.

Konteksti dhe kuadri ligjor e institucional:

Shërbimi shëndetësor në Shqipëri është rregulluar me ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton

parimet kryesore dhe kuadrin ligjor për rregullimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë. Ndërkohë që shërbimi i shëndetit mendor në Shqipëri është rregulluar me ligj të posaçëm që në vitin 1996, përkatësisht me ligjin nr. 8092, datë 21.03.1996, “Për shëndetin mendor”, i cili më pas u shfuqizua me ligjin nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar, që synonte përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e kësaj kategorie. Ky ligj solli nevojën e reformave në lidhje me ngritjen dhe zhvillimin në shkallë kombëtare të kujdesit komunitar të shëndetit mendor si e vetmja mënyrë për të arritur shërbime komunitare të shëndetit mendor për të gjithë (përfshi deinstitutionalizimin të personave që vuajnë sëmundje të shëndetit mendor, monitorimin e të drejtave dhe lirive themelore nga mekanizma të jashtëm, pjesëmarrjen aktive të aktorëve të shoqërisë civile, etj).

Në konceptin gjithëpërfshirës, kuadri ligjor dhe institucional ofron mundësinë e një sistemi të integruar të shërbimeve të shëndetit mendor, i cili nënkupton një rrjet shërbimesh në nivel rajonal.

Gjetjet e evidentuara përgjatë inspektimit :

Në ditën e inspektimit në këtë shërbim me shtretër me kapacitet zyrtar prej 35 personash, respektohej hapësira jetike, kusht ky i domosdoshëm për trajtimin njerëzor të pacientëve në institucione psikiatrike. Në ditën e vizitës monitoruese trajtoheshin 35 pacientë të shtruar, nga të cilët 3 pacientë ndodhen me masë mjekësore të vendosur nga gjykata. Në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, të ndryshuar vazhdonin të silleshin në këtë institucion në bazë të vendimeve gjyqësore, persona me çrregullime të shëndetit mendor, për të cilat gjykatat kanë marrë vendim “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”. Theksojmë se Shërbimi i Shëndetit Mendor me shtretër, Shkodër, nuk është një institucion i posaçëm mjekësor për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilët gjykatat kanë marrë vendim për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”. Sjellim në vëmendje se në ligjin nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar në nenin 28, pika 1 përcaktohet se: *“Institucionet mjekësore të posaçme janë institucione që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor, të të paraburgosurve apo të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion të posaçëm në bazë të nenit 239 të Kodit Procedurës Penale”*. Theksojmë se ligji nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.06.2012, nuk e kushtëzon zbatimin e dispozitave të tij me ndërtimin apo krijimin e institucioneve mjekësore të posaçme nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale.

Grupi inspektues bëri takime private, pa praninë e personelit të shërbimit me **personat me masë mjekësore “mjekim i detyruar”**. Ata për momentin ishin nën kujdesin intensiv të stafit mjekësor, nga biseda private me të sëmurët ata shprehën pozitivitet dhe nuk kishin ankesa për keqtrajtim fizik apo ushtrim dhune nga personeli i këtij shërbimi.

Përgjatë inspektimit u evidentuan mangësi në lidhje me nevojën për mbështetje me investime, kushte me të mira materiale për një shërbim cilësor, nevojë për një numër në rritje të stafeve mjekësore dhe mbështetëse, adresimin e psikiatrisë ligjore ambulatorie apo trajtimin dhe monitorimin e kushteve për personat me çrregullime mendore që kanë kryer vepër penale (personat që vuajnë dënimin me burg apo që janë me masa mjekësore, mjekim i detyruar).

Vështirësi paraqiste **mirëmbajtja e institucionit**, si pasojë e amortizimit ambientet kishin nevojë për investime të qenësishme. Vazhdonte problemi i lagështirës së theksuar dhe nevoja për riparime dhe lyerje pothuajse në të gjithë ambientet e spitalit. Sa më sipër, informohemi se shërbimi shëndetësor me shtretër në Shkodër nuk ka në administrim buxhetin vjetor, çdo parashikim dhe shpenzim varet nga operatori i shërbimeve të kujdesit shëndetësor Shkodër.

Dhomat e pacientëve ishin për akomodimin e 3 personave ato ishin të vendosura në katin e parë dhe të dytë të godinës. **Në përgjithësi dhomat paraqiteshin të pastra dhe me ajrim të mjaftueshëm por nga inspektimi konstatuam se kishin prezencë lagështie, dollapët komodinat dhe krevatet ishin të dëmtuara gjithashtu dhe dyshekët ishin të gjithë të amortizuar.**

Nga ana e drejtueses së institucionit u konfirmua që shtretërit dhe dyshekët aktualë janë blerë para 12 vitesh dhe tani paraqesin rrezik për sigurinë dhe komoditetin e pacientëve, si dhe për higjienën e përgjithshme të institucionit.

Zëvendësimi i shtretërve dhe dyshekëve është i domosdoshëm për të siguruar një mjedis të përshtatshëm dhe dinjitoz për pacientët, duke mbështetur dhe procesin e trajtimit dhe rehabilitimit.

Avokati i Popullit thekson se kjo problematikë është një konstatim i vazhdueshëm dhe nevojitet ndërhyrje **në një kohë sa më të shpejtë nga institucionet përgjegjëse duke shtuar investimet në Spitalin psikiatrik me shtretër Shkodër.**

Përgjatë inspektimit u informuam se kishte marrë zgjidhje problematika e dërgimit të personave abuzues me substancat narkotike dhe alkoolin pranë këtij shërbimi, ashtu si dhe në të gjithë institucionet e tjera psikiatrike në vend.

Institucioni ishte pajisur me aparat EKG, si dhe me aparat për matjen e glicemisë të cilat ishin funksionale.

Analizat laboratorike për pacientet e këtij shërbimi kryheshin në bashkëpunim me Spitalin Rajonal Shkodër.

Në Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër për shtimin e elementeve të sigurisë ishin punësuar roje për të tre turnet e cila kishte dhënë zgjidhje problematikës së situatave ku pacientët mund të largoheshin apo shkaktonin incidente, duke vënë në jo pak raste në rrezik edhe vetë mjekët e shërbimit.

Nga komunikimi i mëvonshëm jemi informuar se furnizimi me complete të përshtatshme fjetjeje, veshmbathje, produkte higjieno-sanitare, dhe pajisje të tjera individuale **nuk ishte realizuar** ende për 6-mujorin e parë të vitit 2025.

Avokati i Popullit vlerëson se **nevojiten furnizime pa vonesa dhe më të shpeshta** për të plotësuar nevojat e institucionit. Furnizimi me materiale të buta, sete çarçafë, batanije dhe jastëk, si dhe produkte higjieno-sanitare, janë të nevojshme dhe nuk duhet të mungojnë për të përmbushur kërkesat e përditshme dhe për të siguruar higjienën optimale.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte siguruar pa ndërprerje, duke u mundësuar personave nën trajtim plotësimin normal të nevojave të tyre. Institucioni kishte një sistem qendror ngrohje, i cili siguronte pjesërisht ngrohje në periudhën e dimrit dhe në verë mungonte ajëri i kondicionuar.

Ambientet e tualeteve dhe dusheve ishin me lagështirë dhe në kushte jo të mira higjieno-sanitare. Pacientët zakonisht bënin dush 2 herë në javë.

Përsa i përket ushqimit, ai sigurohej nga kuzhina e vetë këtij institucioni. Kuzhina ishte e pastër. Sistemi i aspirimit ishte funksional. Kuzhinierët dhe punonjësit që shpërndanin ushqimin, ishin të pajisur me librezën shëndetësore të higjienës. Nga verifikimi i kampionëve ushqimore konstatuam se ato ishin të etiketuara sipas procedurës. Ushqimi ishte i mjaftueshëm dhe nuk kishte raste të refuzimit të tij ai shërbehej 5 pesë herë në ditë (3 vaktet kryesore dhe 2 të ndërmjetme), mëngjesi, vakti para dreke, dreka, vakti i mbasditës, darka. Dieta ushqimore përcaktohej dhe në bazë të nevojave të personave me sëmundje të ndryshme kronike.

Furnizimi me medikamente kishte paraqitur vonesa edhe për vitin 2025 në këtë institucion, ashtu si dhe përgjatë vitit 2024. Institucioni na bëri me dije se për zgjidhjen e kësaj problematike ishin drejtuar me kërkesa tek Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) por përsëri ka pasur vonesa. Aktualisht përgjatë inspektimit konstatuam se mungonin mbi 30 tituj medikamentesh.

Për të gjitha këto mungesa u informuam se shpesh siguroheshin nga familjarët e të sëmurëve.

Shtrimet e pavullnetshme kryheshin në përputhje me nenin 20 të ligjit Nr. 44/ 2012, “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar procedurat ndiqeshin në mënyrë rigoroze, dhe plotësimi i dokumentacionit përkatës nga stafi i mjekëve të këtij spitali kryhej me rregull në të gjitha hallkat e tij.

Aktualisht në Shërbimin e Shëndetit Mendor me shtretër, Shkodër, gjenden 3 pacientë të shtruar për një kohë të gjatë, me masën “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”, që nga viti 2014 dhe pacienti i fundit që ka kohë të gjatë qëndrimi që nga viti 2022.

Puna e shërbimit psikosocial ndahej sipas pavijoneve. Psikologu kryente vlerësimin e funksionimit psikologjik dhe mendor, si pjesë e vlerësimit multidisiplinar, që i bëhet pacientit pas kontaktit të parë në shërbim. Vlerësimi mund të bëhej në bazë të intervistës së strukturuar klinike ose duke përdorur teste të standardizuara të aftësive mendore dhe ose psikologjike. Stafi psiko-social pasi bënte një vlerësim psikologjik fillestar të cilin e pasqyronte në kartelën mjekësore të pacientit, bënte edhe ndjekjen e ecurisë së tij paralelisht me trajtimin terapeutik okupacional. Ky i fundit dokumentohej dhe i bashkëlidhej kartelës mjekësore të pacienti. Raportet për pacientët e shtruar në spital i përcilleshin sektorit psiko-social të Drejtorisë Rajonale Shëndetësore Shkodër, i cili mbikëqyrte mbarëvajtjen e punës në këtë shërbim.

Në shërbimin me shtretër në Shkodër **ka hapësira të kufizuara për pacientët në ambientet e jashtme** ku ata mund të qëndrojnë. Përgjatë inspektimit konstatuam se e vetmja mundësi terapeutike për këta persona ishte salla në të cilën zhvilloheshin aktivitete të ndryshme riaftësuese, individuale dhe në grup.

Nga ana e stafit psiko-social, pacientët trajtoheshin me seanca këshillimore individuale apo në grup, psiko-edukim dhe mbështetje emocionale. Punonjësi social ofronte menaxhimin e rastit që përfshinte krijimin dhe nxitjen e bashkëpunimit midis profesionistëve të ekipit multidisiplinar të një shërbimi dhe midis shërbimeve të ndryshme në funksion të përmirësimit të situatës psiko-sociale apo zgjidhjes së problematikave të një pacienti ose grupi pacientësh.

Nisur nga një numër në rritje i sëmundjeve/çrregullimeve mendore, i tipologjive, i grup moshave, i shtrirjes gjeografike, çrregullimeve për shkak të përdorimit të substancave narkotike etj., lind si domosdoshmëri që praktika dhe politika lehtësuese dhe mbështetëse për shërbimet e shëndetit mendor, të vihen në dispozicion për trajtimin spitalor të këtyre pacientëve. Për këtë ndërhyrje të rëndësishme, strukturat spitalore duhet të krijojnë hapësira për mbështetjen dhe garantimin e shërbimit mjekësor si me terapi medikamentesh, ashtu edhe me terapi psikosociale, në funksion të rikuperimit të këtyre pacientëve.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” të ndryshuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore dhe për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor, të burgosurve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e një dhome izolimi në Shërbimin e Shëndetit Mendor me shtretër Shkodër në përputhje me nenin 27 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e mungesave në medikamente si dhe marrjen e furnizimit të plotë me medikamente të parashikuar sipas nevojave.
4. Marrjen e masave të menjëhershme dhe furnizimin pa vonesa të Shërbimit të Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër me materiale të buta, sete çarçafë, batanije dhe jastëk, si dhe produkte higjeno-sanitare.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e lagështirës të theksuar në të gjitha ambientet veçanërisht në atë të dusheve të Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër.
6. Marrjen e masave për blerjen për shtretër dhe dyshekë të rinj për të gjitha dhomat në Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër.
7. Marrjen e masave për riparimin e të gjitha objekteve të dëmtuara në ambientet e Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër.
8. Marrjen e masave për vënien në funksion të sistemit ngrohje-ftohje në Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër.
9. Marrjen e masave për kryerjen e investimeve në ambientin e jashtëm të Shërbimit me shtretër Shkodër në funksion të pacientëve.

10. Marrjen e masave për informimin e Avokatit të Popullit lidhur me zgjidhjen e problematikave të cilat janë emergjente dhe jetike në funksion të pacientëve të akomoduar në Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

**Mekanizmi Kombëtar për
Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor
ose poshtërues (MKPT)**

AHMET PRENÇI

d.v